



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 20/2 prot.

Tiranë, më 14.01.2022

VENDIM
Nr.6, datë 14.01.2022

PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË ZBATIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 156, DATË 10.12.2021, NË INSTITUCIONIN
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 156, dt. 10.12.2021, “Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Fushë-Arrëz, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Bashkisë Fushë-Arrëz, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 895/1 prot., datë

01.06.2021, ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Pas përfundimit të verifikimit, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, vendimin paralajmërues me Nr. 156, dt. 10.12.2021, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Fushë-Arrëz, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës së konstatuar.

Në kuadër të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, Bashkia Fushë-Arrëz, me shkresën nr. 22 prot., datë 05.01.2022, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur Bashkia Fushë-Arrëz, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim.

Konkretisht, ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit: *****, në pozicionin e punës *“Specialist menaxhimi në shërbimin pyjor”* dhe *****, në pozicionin e punës *“Specialist i tatim-taksave”*, në Bashkinë Fushë-Arrëz.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 156, dt. 10.12.2021, *“Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Fushë-Arrëz, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Fushë-Arrëz.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Fushë-Arrëz.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha